



tirana
EUROPEAN
YOUTH
CAPITAL '22



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR



BASHKIA
TIRANË



Barazia Gjimore

Rinia në krye të ndryshimit





BARAZIA GJINORE

RINIA NË KRYE TË NDRYSHIMIT

FUQIZIM I RINISË SI KAMPIONE E BARAZISË GJINORE - VLERË THELBËSORE E IDENTITETIT EUROPIAN.

Broshura, "Brazia gjinore-Rinia në krye të ndryshimit" u përgatit në kuadër të projektit, "Fuqizim i rinisë, si kampione e barazisë gjinore, vlerë thelbësore e identitetit evropian" mbështetur nga Kongresi Rinor Kombëtar dhe Bashkia e Tiranës, në kuadër të programit për titullin, Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë, #TEYC2022, zbatuar nga "Refleksione" në gjashtë bashki: Berat, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë. Kjo broshurë është vetëm online zbatim të konceptit "go green".

Shqipëria ka një progres të kufizuar drejt një shoqërie me të drejta dhe mundësi të barabarta. Stereotipet dhe paragjykimet e padrejta gjinore janë shkaqet kryesore të një situatë të tillë. Ndërkohë, procesi i integritetit evropian ka nxitur përmirësime të rëndësishme në avancimin e kuadrit ligjor për barazinë gjinore në Shqipëri dhe përafrimin e tij me standardet evropiane. Janë arritur rezultate në çmontimin e stereotipeve gjinore në mendësinë dhe kulturën e shoqërisë. Por Shqipëria ka nevojë për t'i dhënë shtysa të reja barazisë gjinore dhe adresimit të stereotipeve gjinore diskriminuese që ushqejnë pabarazinë.

Rinia në Shqipëri, me potencialin e saj është shpresa më e madhe për këto shtysa dhe impulse të reja për ndryshime pozitive pasi ajo përbën segmentin më të madh dhe më pro-evropian të popullsisë. Fuqizimi i rinisë, rritja e kapaciteteve të saj për të kundërshtuar stereotipet gjinore dhe u shndërruar në një faktor vendimtar për avancimin e barazisë gjinore, si vlerë thelbësore e identitetit evropian është në qendër të kësaj broshure. Broshura ofron informacion për domethënien e barazisë gjinore, rëndësinë e saj në stabilitetin dhe prosperitetin e shoqërisë, paragjykimet dhe stereotipet gjinore, kuadrin ligjor kombëtar të përafruar me atë të Bashkimit Evropian.

Realizuan broshurën:

- | | |
|--------------------|------------------------|
| Ani Ruci | • Drejtore e projektit |
| Afërdita Prroni | • Eksperte gjinore |
| Violanda Theodhori | • Eksperte ligjore |
| Romina Pambuku | • Koordinatore |
| Gentian Gjikopulli | • Kopertina |

PARATHËNIE

Ne kemi bindje që rinia pro-europiane e Shqipërisë është faktori vendimtar për të sjellë ndryshimin pozitiv drejt një shoqërie me të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë. Ne besojmë që rinia me potencialin dhe energjinë e saj është promotori për ndryshimin shoqëror pozitiv, ku vajza dhe djem, gra dhe burra janë realisht të barabartë në të gjitha fushat e jetës, të respektuar dhe të barabartë në jetën publike dhe private.

Me këtë bindje “Refleksione” publikon on line broshurën “Barazia gjinore-Rinia në krye të ndryshimit,” si kontribut për të ndikuar në afrimin në kohë të ndryshimit pozitiv. Kjo broshurë i drejtohet gjithë rinisë së vendit, komuniteteve rinore në zona urbane dhe rurale, vajzave dhe djemve të rinj aktivistë dhe vullnetarë të progresit, organizatave të Kongresit Rinor Kombëtar, departamenteve të rinisë në bashkitë e vendit, Këshillave dhe Senateve rinore, institucioneve qendrore që kanë në fokus të tyre rininë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Përkrahjes Sociale.

Avancimi i kufizuar drejt barazisë gjinore mbetet shqetësues në kuadër të progresit të Shqipërisë në procesi e integritimit europian, konkretisht me hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE, në korrik të këtij viti.

“Refleksione” synon të rrisë ndërgjegjësimin e rinisë për rolin e saj vendimtar në çmontimin e stereotipeve dhe paragjytimeve gjinore që ushqejnë pabarazinë dhe diskriminimin për t’i hapur rrugën emancipimit shoqëror, përparimit dhe ecjes drejt forcimit të identitetit europian të rinisë.

“Refleksione” falenderojnë përzemërsisht dhe i shprehin mirënjohjen e tyre Kongresit Rinor Kombëtar, Bashkisë së Tiranës që mbështeti financiarisht zbatimin e projektit “Fuqizim i rinisë si kampione e barazisë gjinore, vlerë thelbësore e identitetit europian” në kuadër të programit #TEYC2022 dhe mundësoi përgatitjen on line të kësaj broshure si një nga produktet e projektit, i cili përmbillet me Ekspozitën Kombëtare në artet pamaore,” Thyejmë stereotipe gjinore, ndërtojmë të ardhmen e barabartë” me krijime të talenteve të reja, vajza dhe djem nga gjashtë bashkitë: Berat, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë.

Ani Ruci
Drejtoreshë Ekzekutive,
Refleksione



ÇFARË DO TË THOTË FJALA GJINI?

Kjo fjalë përdoret për të treguar identitetet, sjelljet dhe praktikat që lidhen me të qënurit vajzë / grua ose djalë / burrë. Gjinia është një koncept i ndryshëm nga seksi, pasi i referohet karakteristikave fizike dhe biologjike të një personi. Eliminimi i diskriminimit në bazë të gjinisë është parakusht për një shoqëri më të barabartë dhe një faktor shumë i rëndësishëm në parandalimin e të gjitha formave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj vajzave/grave, djemve/burrave.

Çfarë është Barazia Gjinore?

Barazia gjinore është një e drejtë njerëzore, e domosdoshme për të gëzuar të drejtat e tjera njerëzore dhe patur shoqëri në paqe. Barazi gjinore do të thotë barazi për të gjithë, pavarësisht nga raca, gjinia, të ardhurat dhe aftësitë dhe orientimi seksual. Barazi gjinore do të thotë që aksesin në të drejta dhe mundësi të mos varet nga gjinia. Nga pabarazia gjinore preken vajza dhe gra, djem dhe burra. Në këto kontekste barazi gjinore do të thotë që vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat të kenë të drejta, përgjegjësitë dhe mundësi të barabarta dhe këto të mos kushtëzohen nga gjinia në lindje.

Barazia gjinore është parakusht për një shoqëri ku pjesëtarët e saj janë të barabartë dhe një faktor shumë i rëndësishëm për sukses në parandalimin e të gjitha formave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Ajo mbështetet në konceptin se të gjitha qëniet njerëzore, pa dallim nga identiteti i tyre gjinor, janë të barabarta në dinjitet dhe të drejta; janë të lira për të zhvilluar aftësitë e tyre personale, ndjekur karrierën profesionale, bërë zgjedhje pa diskriminim dhe kufizime të vendosura nga stereotipe, paragjykime dhe role të ngurta gjinore.

Barazia gjinore në familje.

Mesatarisht, vajzat dhe gratë në Shqipëri, por në përgjithësi në gjithë botën, bëjnë disa herë më shumë punë të papaguar në shtëpi sesa djemtë dhe burrat. Fjala është për punët shtëpiake, kujdesin për fëmijët dhe anëtarët e familjes kur një pjesë e mirë e tyre janë në shkollë ose në punë. Barazi gjinore në familje di të thotë një ndarje sa më e barabartë e punëve në shtëpi për të gjithë anëtarët e familjes, vajza dhe djem.

Barazi gjinore: Pagë e barabartë për punë të barabartë

Hendeku i pagave midis vajzave dhe djemve që punojnë, grave dhe burrave mbetet ende i thellë në Shqipëri dhe mbarë botën. Barazi gjinore në punësim do të thotë të paguhesh me të njëjtën pagë për punë të barabartë, pavarësisht nga gjinia.

Barazi gjinore: Tolerancë “Zero” ndaj ngacmimeve seksuale dhe paragjykimeve gjinore.

Vajza dhe djem, burra dhe gra meritojnë të ndihen të sigurtë në çdo mjedis dhe të jenë të lirë nga ngacmime seksuale dhe paragjykime të bazuara në gjininë e tyre. Një shoqëri që vlerëson dhe mbështet barazinë gjinore nuk lejon që komentet fyese dhe çdo lloj ngacmimi të tolerohet.

Si shprehet barazia gjinore, cilat janë përfitimet prej saj?

Barazia gjinore i bën mjedisin dhe komunitetet ku ne jetojmë më të sigurt dhe më të shëndetshme. Barazia gjinore shfaqet në barazinë ekonomike: vajza dhe djem, burra dhe gra kanë mundësi të barabarta për t'u punësuar dhe për rrjedhojë nga kjo përfiton shoqëria. Kur të gjitha gjinive u jepen mundësi të barabarta punësimi, nivelet e varfërisë reduktohen, në komunitetet ku ne jetojmë ngrihet niveli i jetesës dhe zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i vendit ecën përpara.

Barazi gjinore shprehet në arsimim.

Vajzat që marrin arsim kanë më shumë shanse për të qenë më të shëndetshme dhe më produktive duke fituar të ardhura më të larta dhe duke ndërtuar të ardhme më të mirë për vehte dhe familjet e tyre. Arsimit i tyre kontribuon për një ekonomi më të fortë në familje dhe në komunitetet lokale. Kur një vajzë arsimohet të ardhurat e saj gjatë gjithë jetës rriten dhe kjo ndikon në zhvillimin e saj individual, të familjes, komunitetit dhe mbarë shoqërisë.

Barazia gjinore shprehet në aksesin e barabartë në shërbimet shëndetësore.

Barazia gjinore ka një ndikim pozitiv në rezultatet shëndetësore: në shëndetin e nënës dhe fëmijës. Kur sistemet shëndetësore ofrojnë akses të barabartë në kujdesin shëndetësor për të gjitha gjinitë atëhere rezultatet shëndetësore janë më të mira, shkalla e vdekshmërisë është më e ulët.

PABARAZIA GJINORE

Pabarazia gjinore ka të bëjë me normat dhe rolet gjinore, praktikat kulturore dhe politikat, ligjet dhe faktorët ekonomikë, praktikat institucionale që të gjitha së bashku kontribuojnë për të përjetësuar marrëdhënie të pabarabarta mes vajzave/ grave dhe djemve/burrave në raport me pushtetin. Kjo pabarazi në mënyrë disproporcionale i pengon dhe dëmton gratë të kenë vendin që u takon në shoqëri dhe gjithë fushat e jetës. Pabarazia gjinore rezulton në shpërndarje të pabarabartë të pushtetit, burimeve, mundësive dhe aftësive, pasi djemve/burrave u është dhënë më shumë se vajzave/grave për shkak të normave dhe strukturave diskriminuese gjinore. Pabarazia gjinore është në të njëjtën kohë shkak dhe rezultat i dhunës së djemve ndaj vajzave apo burrave ndaj grave.

Ndërkohë, pabarazia gjinore prek të gjithë, përfshirë djemtë dhe burrat. Stereotipet ose “rregullat” se si vajzat/gratë dhe djemtë/burrat duhet të sillen fillojnë në fëmijëri dhe vazhdojnë deri në moshën madhore. Stereotipet gjinore ndikojnë në sjelljen e vajzave dhe djemvetë rinj, në zgjedhjen e tyre se për çfarë do të studiojnë, çfarë profesioni do të marrin, në ambiciet dhe në marrëdhëniet me të tjerët. Stereotipet tradicionale gjinore janë të vështira për djemtë dhe burrat për t'u përmbushur, të cilët ndejnë presion për të qenë “burra të vërtetë”, të fortë fizikisht dhe emocionalisht dhe të jenë ata që sjellin të ardhurat kryesore në familje. Djemtë e rinj kanë më shumë gjasa të përdori pije alkolike apo drogë, të ndërmarrin rreziqe jo të shëndetshme dhe të përfshihen në dhunë.

Stereotipet gjinore

Stereotipe Gjinore janë pikpamje, këndvështrime ose paragjykime të përgjithësuara lidhur me tipare, karakteristika, veti dhe role që duhen të kenë apo luajnë në shoqëri vajzat /gratë, djemtë/burrat.

Norma gjinore dhe sociale

Këto përcaktojnë veprime të pranueshme dhe të përshtatshme për vajzat / gratë dhe djemtë/ burrat në një grup ose shoqëri të caktuar. Normat gjinore dhe sociale janë të ngulitura në institucione formale dhe joformale, të vendosura në mendjen e njerëzve dhe që prodhohen dhe riprodhohen përmes bashkëveprimit shoqëror.

Rolet gjinore

Rolet gjinore në shoqëri lidhen me pritshmëritë se si duhet të veprojmë, të flasim, të vishemi, të sillemi në bazë të përkatësisë gjinore dhe seksit, të qenit femër apo mashkull. Rolet gjinore ndikojnë në një gamë të gjerë të sjelljes njerëzore, që nga veshja që një person zgjedh, profesionin që ndjek, marrëdhëniet personale që ndërton. Organizata Botërore e Shëndetësisë i përcakton rolet gjinore si “role, sjellje, veprimtari dhe attribute në marrëdhëniet shoqërore, që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për vajzat/gratë, djemtë/burrat

Dhuna në familje

Dhuna në familje mund të përshkruhet si pushtet i keqpërdorur nga një i person i rritur për të kontrolluar një person tjetër në marrëdhëniet familiare. Përmes saj dhe formave të tjera të abuzimit synohet vendosja e kontrollit dhe frikësimit në një marrëdhënie familiare. Kjo dhunë mund të jetë sulm fizik, abuzim psikologjik, social, financiar dhe seksual. Ajo kryhet nga djem dhe vajza, burra dhe gra, por në shumicën e rasteve viktimat e saj janë vajza/gra.

Dhuna në familje është forma më e përhapur e dhunës ndaj vajzave/grave, që ndikon tek gjatë tërë jetës së tyre dhe ka pasoja të rënda si për viktimat e saj ashtu edhe për shoqërinë në tërësi.

Dhuna kundër grave dhe vajzave

Këto përcaktojnë veprime të pranueshme dhe të përshtatshme për vajzat / gratë dhe djemtë/ burrat në një grup ose shoqëri të caktuar. Normat gjinore dhe sociale janë të ngulitura në institucione formale dhe joformale, të vendosura në mendjen e njerëzve dhe që prodhohen dhe riprodhohen përmes bashkëveprimit shoqëror.

SI MUND TË BËHET REALITET BARAZIA GJINORE?

Tre janë hapat kryesorë: **Ndërgjegjësimi, Arsimimi, Zbatimi i ligjeve**

Ndërgjegjësimi

është hapi i parë drejt çdo përparimi në barazinë gjinore. Nëse një shoqëri nuk është në gjendje të pranojë egzistencën e pabarazisë gjinore, ndryshimet positive do të jenë pothuajse të pamundura. Për ta bërë realitet barazinë gjinore, ne duhet të jemi të vetëdijshëm për gjendjen aktuale dhe përfitimet e progresit drejt saj.

Arsimimi:

Qasja e pabarabartë në arsimim konsiderohet si pengesa më e rëndësishme për barazinë gjinore. Pa të njëjtin arsim si vajzat ashtu edhe djemtë janë të kufizuar në të ardhurat dhe perspektivat përpunësim. Mungesa e arsimit ka një efekt domino në çdo fushë të jetës së tyre. Për të trajtuar pabarazinë gjinore arsimit për vajzat mbetet një prioritet kryesor

Zbatimi i legjislacionit kombëtar

të Shqipërisë për barazinë gjinore dhe kundër diskriminimit gjinor si edhe i dispozitave të Konventave Europiane dhe Ndërkombëtare ku Shqipëria është palë ka rëndësi në progresin e barazisë gjinore. Njohjen dhe respektimin e të drejtave të barabarta ligjore ndërmjet vajzave dhe djemve, grave dhe burrave i garanton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku promovohen parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale”. Barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimit gjinor, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje i dedikohen ligje të veçanta.

Ligji **“Për rininë”** parashikon që: “Mbështetja dhe fuqizimi i të rejave/rinjve bazohet në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rejave/rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare,

punësimi, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rejave/rinjve.

Ligji **“Për barazinë gjinore në shoqëri”** ligji rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë të vajzave dhe djemve, grave dhe burrave lidhur me mundësitë dhe shanset e barabarta në të drejtat dhe pjesëmarrjen në të gjitha fushave të jetës.

Ligji **“Për mbrojtjen nga diskriminimi”**, sipas të cilit askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Ligji **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”**, që garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta si viktima të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimittëqenieve njerëzore, të mitur/mitur-anëkonflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, persona, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim.

Dispozitat e Konventave Ndërkombëtare.

Në kryetë tyre qëndron “Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje” e Këshillit të Europës, e njohur ndryshe edhe si “Konventa e Stambollit” sipas emrit të kryeqytetit të Turqisë ku vndeantaretë KëshillittëEuropës hapën procrsin e firmosjes së saj në maj 2011. Kjo Konventë është një traktat madhor për të drejtat e njeriut që vendos standarde ligjore gjithëpërfshirëse për të garantuar të drejtën e vajzave dhe grave për të qenë të lira nga dhuna. Të gjitha qvendet anëtare të Këshillit të Europës ë kanë ratifikuar këtë traktat janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e saj. Konventa e Stambollit e njeh dhunën ndaj vajzave/grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave. Ai mbulon forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore ndaj vajzave/grave, që i referohet dhunës ndaj tyre për shkak se ato janë vajza dhe gra .

Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.

Kjo konventë ndërkombëtare e njohur edhe si CEDAË, (Convention on Elimination of all Forms of Discrimination Against Women) Konventa e përkufizon diskriminimin ndaj vajzave/grave si "çdo dallim, përjashtim ose kufizim i bërë në bazë të seksit që ka efekt ose qëllim të dëmtojë ose anulojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga vajzat/gratë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër". Shtetet që kanë pranuar Konventën, mes të cilve edhe Shqipëria, angazhohen të ndërmarrin një sërë masash për t'i dhënë fund diskriminimit të vajzave/ grave në të gjitha format. Ato marrin përsipër të përfshijnë parimin e barazisë mes vajzave/grave dhe djemve/ burrave në sistemin e tyre ligjor, të shfuqizojnë të gjitha ligjet diskriminuese dhe të miratojnë ato të përshtatshme që ndalojnë diskriminimin ndaj vajzave/ grave; të krijojnë gjykata dhe institucione të tjera publike për të garantuar mbrojtjen efektive të vajzave/grave ndaj diskriminimit. Konventa afirmon të drejtat riprodhuese të vajzave/grave dhe synon kulturën dhe traditën si forca me ndikim që formësojnë rolet gjinore dhe marrëdhëniet familjare. Ajo afirmon të drejtat e vajzave/grave për të fituar, ndryshuar ose mbajtur shtetësinë e tyre dhe kombësinë e fëmijëve të tyre. Shtetet, palë në këtë konventë kanë rënë gjithashtu dakort të marrin masat e duhura kundër të gjitha formave të trafikut dhe shfrytëzimit të vajzave/ grave. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, (CEDAË) u miratua më 2 shtator 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Kjo konventë u nënshkrua në vitin 1950 nga Këshilli i Evropës. Ajo është një traktat ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Evropë. Të 47 vendet që formojnë Këshillin e Evropës janë palë në Konventë, 27 prej të cilave janë anëtarë të BE-së. Konventa themeloi Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me qëllim mbrojtjen e individëve nga shkeljet e të drejtave të njeriut. Çdo person, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas Konventës nga një shtet palë, mund të çojë një çështje në Gjykatë. Kjo ishte një veçori inovative, pasi u jepte individëve të drejta në një arenë ndërkombëtare. Vendimet që konstatojnë shkelje janë të detyrueshme për vendet në fjalë. Konventa ka disa protokolle, të cilat ndryshojnë kornizën e saj.

Rinia – kampione e barazisë gjinore

Shqipëria ka shënuar progres në barazonë gjinore. Por ende në shoqëri ekziston mentalitet patriarkal nga buron diskriminimi gjinor përqipet t'iu mohojë vajzave të drejtat e tyre të plota njerëzore: qasjen në arsim, kujdes shëndetësor, punësim, pronësi si edhe rolin e tyre në komunitetet ku jetojnë. Ndërkoë që vajzat/gratë përbëjnë "gjysmën e qiellit" dhe për më tepër gjithë shoqëria humbet kur të drejtat e vajzave/grave nuk respektohen sepse diskriminimi zvogëlon potencialin real të shoqërisë për zhvillim të saj social dhe ekonomik.

“Refleksione” beson fort se në Shqipëri mund të kemi një shoqëri që kundërshton diskriminimin dhe lëniën mënjane për shkak të gjinisë për mes angazhimit të rinisë si kampione e barazisë gjinore që kundërshton stereotipet dhe paragjykimet gjinore që synojnë të përjetësojnë pabarazinë dhe diskriminimin. Stereotipi gjinor është shkelje e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të vajzave /grave dhe djemve që përbën një pengesë serioze për arritjen e barazisë reale gjinore pasi përjetëson diskriminimin, trajtimin e pabarabartë ose të padrejtë”. Në shoqëinë tonë duhet spostuar mendimi që "të rinjtë, djemtë janë pjesë e problemit" në "të rinjtë/ djemtë janë pjesë e zgjidhjes".

Të rejtat të rinjtë janë faktori kyç për të patur një shoqëri ku të vajzat/gratë dhe djemtë/burrat gëzojnë të njëjtat të drejta, të kenë akses të barabartë në burime dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse në kushte të barabarta. Barazia gjinore nuk nënkupton një uniformitet të plotë të vajzave/grave dhe djemve /burrave, por mundësi të njëjta për të dy gjinitë për pjesëmarrje dhe kontribut në shoqëri

Nga aktivitetet e projektit;

"Fuqizim i rinise si kampione e barazise gjinore-vlere thelbesore e identitetit europia" zbatuar nga Refleksi-one, mbedhtetur nga Kongresi Rinor Kombetar dhe Bashkia e Tiranës, ne kuader te titullit #TEYC2022.













BARAZIA GJINORE - RINIA NË KRYE TË NDRYSHIMIT





Refleksione
Gjërat janë gati të ndryshojnë